

VENDIM
Nr.734, datë 1.11.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MBYLLJEN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT, PËR NDËRMARRJEN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, ELBASAN,
DHE LEJIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
TË BLEJË 100 PËR QIND TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “BERLINWASSER
INTERNATIONAL, GmbH” NË “ELBER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të ligjit nr.8783, datë 7.5.2001 “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “Bot”, ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe “Berlinwasser International, GmbH”, për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe ujë-kanalizimeve Elbasan, si dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për mbylljen e kontratës së koncesionit, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe shoqërisë “Berlinwasser International GmbH” për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve Elbasan.

2. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të blejë 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “Berlinwasser International, GmbH” në “Elber” sh.p.k. (ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve të qytetit të Elbasanit), me vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

3. Fondi për blerjen e këtyre aksioneve të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpenzime operative”, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ngritjen e grupit të punës, me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për negociimin, me shoqërinë “Berlinwasser International GmbH”, të kushteve, teknike e juridike, të kontratës së shitblerjes së këtyre aksioneve.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme tekniko-juridike dhe të autorizimeve përkatëse për realizimin e procedurave.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha